




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 303, datë 20.4.2016

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1197,
DATË 3.12.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPALLJEN
E KALASË SË TIRANËS "ZONË ARKEOLOGJIKE "A""
DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 30, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.1197, datë 3.12.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 3, të vendimit, emërtimet "Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve" dhe "Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit" ndryshojnë dhe bëhen, përkatësisht, "Ministria e Kulturës" dhe "Ministria e Zhvillimit Urban".
2. Pika 1, e nenit 2, të rregullores, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Konservimi dhe restaurimi i mureve rrethuese dhe strukturave të tjera arkeologjike të kalasë, kryerja e formave të testimit, të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, projektet kërkimore shkencore, të miratuara nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve."
3. Në pikën 2, të nenit 2, të rregullores, para fjalës "Restaurimi..." shtohen fjalët "Konservimi dhe..."

4. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal), me lartësi maksimale 1 kat, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara.

Konstruksionet, në funksion të ruajtjes, ekspozimit, informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, në veçanti, dhe trashëgiminë kulturore, në përgjithësi, si dhe nevoja të tjera të rikualifikimit urban të zonës, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe, në asnjë rast, nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peisazhin.

Projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë qartë qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës si dhe planprojektin e saj.

Vendosja e tyre bëhet me mbikëqyrjen e autoriteteve të specializuara shtetërore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

MINISTRI I KULTURËS

MIRELA KUMBARO FURXHI

NR.PROT.1860/3
DATË 24.4.2016

MINISTRISË SË KULTURËS .
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME
PARLAMENTIN
MINISTRIT TË SHTETIT PËR ÇËSHTJET VENDORE
BASHKISË SË TIRANËS
AGJENCISË SË SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

